



REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA · REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Prodato Received/Delivety		06.07.2022	2	viti god year
Organ /Niesta Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPM/SHK	3949/2022		1/4	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 499/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga; Eshref Shabani -kryetar, Malsore Gashi – Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.499/2022 të datës 03.06.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë banimi [redacted]

[redacted] kundër organit të punësimit/Agjencia Kundër Korrupsionit, ne çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.499/2022 e datës 03.06.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] përmes emailit zyrtar, më datë 03.06.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën „Specialiste e Administrimit të Përgjithshëm”, të publikuar nga Agjencia kundër Korrupsionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitive Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 10.06.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje ne ankesë në Agjencia Kundër Korrupsionit. Ndërsa, Këshilli më datë 16.06.2022 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 3242/2022 të datës 03.06.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër protokollit 01-2370/22, i datës 31.05.2022; e-maili i datës 25.05.2022; Kërkesë e datës 25.05.2022, me numër protokollit 01-2231/22, për qasje në dokumente publike; Renditja përfundimtare e kandidateve; Vendimi i datës 28.04.2022, me numër protokollit 01-1977/22; Konkursi i datës 13.04.2022; Vendimi i datës 28.04.2022, me numër protokollit 01-1977/22;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted] është palejuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka gjetur se Agjencia Kundër Korrupsionit, më datë 06.04.2022 ka publikuar konkursin me Nr.Reference RN00008614 për grup Specialist i Administrimit të Përgjithshëm, ku afati për aplikim ka qenë nga data 06.04.2022 deri më datë 13.04.2022. Në këtë konkurs në bazë të listës së kandidatëve ka aplikuar dhe ankuesja. Pas përfundimit të rregullt të procedurës së pranimit për pozitën e lartcekur, Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë Kundër Korrupsionit, ka publikuar renditjen përfundimtare të kandidatëve kur rezulton se ankuesja është vlerësuar me gjithsej 90.6 pikë duke u renditur e dyta, dhe e njëjta më datë 24.05.2022, për mes e-mail, nga [redacted] është njoftuar, lidhur me drejtën e ankesës në afatin prej tri (3), ditësh.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se ka pasur shkelje procedurale gjatë kësaj procedurë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të shqyrtimit të provave të lëndës, konstaton se bazuar në emailin e datës 24.05.2022, nga [redacted] ankuesja është njoftuar, lidhur me drejtën e ankesës në afatin prej tri (3), ditësh, ndërsa ankuesja në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil nuk ka sjell asnjë dëshmi që ka parashtruar ankesë në Komisionin e Pranimit, këtë e ka konfirmuar edhe autoriteti punëdhënës në përgjigje në ankesë të datës 15.06.2022, ku ka theksuar që: *"...Mirëpo ndoshta është në interes të juajin të ju njoftoj që kandidatja në fjalë nuk e ka shterë mundësin e anekses brenda institucionit pra nuk ka bërë ankesë në Agjencinë Kundër Korrupsionit"*.

Sipas nenit 31 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përcaktohet se: *"1.Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet"*, e në kuptim të kësaj bazë ligjore rrjedhë se ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër një procesi të

pranimit në shërbimin civil, parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës së brendshme të ankesës tek organi që ka shpall procedurën e pranimit. Ndërlidhur me këtë, paragrafi 4 i nenit 31 të Rregullores si me lartë shprehimisht thekson se: *“Ankesa ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, mund të paraqitet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës. Procedura e brendshme e ankesës, vlerësohet së është shteruar nëse: 4.1. kandidati i pakënaqur me rezultatet e verifikimit paraprak ka parashtruar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 15 të kësaj rregulloreje; 4.2. kandidati i pakënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar, ka parashtruar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 25 të kësaj rregulloreje, apo 4.3. kandidati është cenuar drejtpërdrejtë nga aktet me të cilat është zgjidhur ankesa e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 15, sipas paragrafit 6 të nenit”.*

Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji i Këshillit nga vlerësimi i provave lidhur me këtë procedurë të rekrutimit ka konstatuar se përkundër që me emailin e 24.05.2022 nga ankuesja është njoftuar, lidhur me drejtën e ankesës në afatin prej tri (3) ditësh, me asnjë provë nuk dëshmohet së ankuesja të këtë parashtruar ankesë të brendshme, respektivisht meqenëse ankuesja është e pakënaqur me fazën e vlerësimit atëherë në vështrim të bazës ligjore si më lartë ankuesja duhej të ushtronte fillimisht ankesë pranë Komisionit të Pranimit ashtu siç është përcaktuar me nenin 25 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku thuhet se: *“...Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtrojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual”*, kështu që pas konstatimit së ankuesja ka ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pa shteruar procedurën e ankesës së brendshme, Kolegji në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton së ankesa A.nr.499/2022 e datës 03.06.2022, e parashtruar nga ankuesja është e papranueshme.

Siç u tha me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.499/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kundër Korrupsionit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

